

# AKT – THEMELIMI



## **I SHOQERISE TREGTARE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **"GRIMER GABION" SHPK**

Bazuar ne vullnetin e ortakeve themelues dhe mbeshtetur ne Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ndryshuar me Ligjin nr. 10 475, date 27.10.2011 vendoset si me poshte:

#### **Kreu I**

#### **Themelimi, Emri, Objekti, Kohezgjatja dhe Selia e Shoqerise.**

##### **Neni 1:**

#### **Themelimi, Themeluesit, Emri.**

*Sot me date 22/02/2017* themelohet shoqeria me pergjegjesi te kufizuar me emrin:

### **"GRIMER GABION" SHPK**

Themeluesit e shoqerise **"GRIMER GABION" SHPK**

jane Z. **Daniel Merko**, atesia Sami ,lindur me 27.05.1974, lindur ne Elbasan, mbajtes i pashaportes nr.BF6398033, numer personal H40627169I, banues ne Elbasan, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, **2. Dritan Gripshi**, atesia Tahsim lindur me 02.05.1975, lindur ne Peqin, mbajtes i pashaportes nr.BA6146956, numer personal H50502012O, banues ne lagja "Brigada 17 S", Elbasan, me zotesi te plote juridike e per te vepruar;.

##### **Neni 2:**

#### **Objekti i Shoqerise.**

- 1) Import-eksport, tregtim me shumice e pakice, prodhim per mallra industriale, lende te pare e te perpunuar, hidraulike, materiale ndertimi, duroalumine, pajisje elektrike, transport mallrash brenda e jashte vendit, grumbullim, perpunim e tregtim lendesh te para te cdo lloji, linja prodhimi.

##### **Neni 3:**

#### **Kohezgjatja e shoqerise.**

Kohezgjatja e shoqerise do te jete per nje periudhe te pacaktuar.

##### **Neni 4:**

#### **Selia e shoqerise**

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"GRIMER GABION" SHPK**, ka seline e saj ne " Elbasan, Elbasan Ish-Uzina 12 NI-CO ". Shoqeria mund te kryeje e te

transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

## **Kreu II**

### **Kapitali i shoqerise.**

#### **Neni 5:**

#### **Vlera dhe pagesa e kapitalit te paguar**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njqind mije) leke. Pjesemarrja e themelueseve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tyre si vijon :

Lloji i kontributit eshte ne para ne vleren 100 000 (njqind mije) leke, i ndare ne 2 kuota ne vleren

50 000 (pesedhjetje mije) leke, e cila perben 50 % vleren e kapitali themeltar e cila i perket **Daniel Merkos**, 50 000 (pesedhjetje mije) leke, e cila perben 50 % vleren e kapitali themeltar e cila i perket **Dritan Gripshit**.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte shlyer dhe nenshkruar teresisht nga ortaket e shoqerise.

## **Kreu III**

### **Administratori i shoqerise.**

#### **Neni 6:**

#### **Emerimi dhe kohezgjatja e Administratorit.**

Asambleja e pergjithshme zgjedh nje ose me shume persona fizike si administratore te shoqerise per nje periudhe pese vjecare (5vjet), ne pajtim me parashikimet e Ligjit 9901 date 14.04.2008, i ndryshuar. Emertimet do te jene individuale dhe sipas nje vendimi te marre me shumice te zakonshme nga Asambleja e Pergjithshme.

Administratori i pare i shoqerise per nje periudhe 5 (pese) vjecare do te jete, **Z. Dritan Gripshit**.

## **Kreu IV**

### **Dispozitat Perfundimtare.**

#### **Neni 7:**

Marredheniet e punesimit ne shoqeri do te rregullohen nepermjet kontrates se punesimit qe lidhet midis paleve ne mbeshtetje te Kodit te Punes si dhe akteve nenligjore te dala ne zbatim te tij.

Ortaku /ortaket e shoqerise nuk kufizohen ne rritjen e kapitalit te Shoqerise.

Mosmarreshjet qe mund te lindin gjate ushtrimit te veprimtarise private, midis ortakeve, punonjesve dhe personave te trete, kur ato nuk mund te zgjidhen me mirekuptim, mbetet ne kompetence te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Elbasan.



Shoqeria do te kete vulen e saj ku jane percaktuar dhe inicialet e emertimit tregtar. Modalitet per ndryshimin dhe kompetencat e administratorit, kompetencat dhe marrja e vendimeve te Asamblese se Pergjithshme, zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit themeltar, etj, do te rregullohen nga Statuti i Shoqerise dhe Ligji 9901 14.04.2008 "2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", i ndryshuar si dhe Ligji 9723, date 03.05.2007 "Per QKB", i ndryshuar.

Ky akt themelimi eshte perpiluar ne kater kopje me vlere te njejete me origjinalin.


Elbasan, me date 22/02/2017

**THEMELUES:**

**Z. Daniel Merko**

*Daniel Merko*  


**Z. Dritan Gripshi**

*Dritan Gripshi*  


# STATUT

## I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

### "GRIMER GABION" SHPK

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"GRIMER GABION" SHPK**, eshte themeluar nga 2 ortak Z. **Daniel Merko**, atesia Sami ,lindur me 27.05.1974, lindur ne Elbasan, mbajtes i pashaportes nr.BF6398033, numer personal H40627169I, banues ne Elbasan, me zotesi te plote juridike e per te vepruar, **2. Dritan Gripshi**, atesia Tahsim lindur me 02.05.1975, lindur ne Peqin, mbajtes i pashaportes nr.BA6146956, numer personal H505020120, banues ne lagja "Brigada 17 S", Elbasan, me zotesi te plote juridike e per te vepruar; ne perputhje me ligjet e Republikes se Shqiperise nr. 9901 date 14.04.2008, "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar dhe ligjit 9723 date 03.05.2007"Per Qendren Kombetare te Regjistrimit", te ndryshuar.

### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

#### Neni 1

Shoqeria eshte person juridik i se drejtes shqiptare dhe gezon te drejatat e personit juridik nga data e regjistrimit ne Qendren Kombetare te Bizneseve . Shoqeria zhvillon aktivitetin e saj ne perputhje te plote me legjislacionin shqiptar dhe dispozitat e aktit te themelimit e te ketij statuti.

### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE**

#### Neni 2

- 1) Import-eksport, tregtim me shumice e pakice, prodhim per mallra industriale, lende te pare e te perpunuar, hidraulike, materiale ndertimi, duroalumine, pajisje elektrike, transport mallrash brenda e jashte vendit, grumbullim, perpunim e tregtim lendesh te para te cdo lloji, linja prodhimi.

### **SELIA E SHOQERISE**

#### Neni 3

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar **"GRIMER GABION" SHPK**, ka seline e saj ne " Elbasan, Bradashesh Ish-Uzina 12 NI-CO " Pasurie nr.948/2, zona kadastrale 3965, me, volum 6, fq.199 ,te ndodhur ne Bradashesh, Metalurgji. Shoqeria mund te kryeje e te transferoje, apo te suprimoje qendra administrative, seli, filiale, agjensi dhe zyra ne territorin e Republikes se Shqiperise dhe jashte vendit.

### **KOHEZGJATJA**

#### Neni 4

Kohezgjatja e veprimtarise se shoqerise do te jete pa afat, me mundesine e zgjatjes apo te shkurtimit te afateve, te ndryshoje veprimtarine, emertimin, seline, objektin e veprimtarise sipas vendimit te ortakeve te shoqerise.



## DETYRIMET E ORTAKEVE

Neni 5

Ortaku i vetem i shoqerise duhet te kryeje depozitim e kapitalit themeltar per llogari te shoqerise ne nje banke te caktuar prej tij.

## TRANSFERIMI I KUOTAVE

Neni 6

Ortaket mund te kalojne pjesen nga kapitali themeltar i personave te tjere ne perputhje me rregullat e parashikuara ne nenin 73 te ligjit 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

## PARAQITJA KONTABILE

Neni 7

Operacionet e shoqerise kontabilizohen duke aplikuar parimet e kontabilitetit te parashikuara ne legjislacionin shqiptar dhe paraqitjen me saktesi ne bilancin vjetor te aktivitetit.

Ne mbyllje te cdo viti ortaket ose personi i ngarkuar prej tij, ben inventarizimin dhe llogarite vjetore ne perputhje me dispozitat e legjislacionit ne fuqi per kontabilitetin dhe harton raport me shkrim. Ky raport pasqyron gjendjen e shoqerise gjate vitit financiar.

## KAPITALI THEMELTAR

Neni 8

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 100 000 (njqind mije) leke. Pjesemarrja e themelueseve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributin e tyre si vijon : Lloji i kontributit eshte ne para ne vleren 100 000 (njqind mije) leke, i ndare ne 2 kuota ne vleren

50 000 (pesedhjete mije) leke, e cila perben 50 % vleren e kapitali themeltar e cila i perket **Daniel Merkos**, 50 000 (pesedhjete mije) leke, e cila perben 50 % vleren e kapitali themeltar e cila i perket **Dritan Gripshit**.

Kapitali themeltar i shoqerise eshte shlyer dhe nenshkuar teresisht nga ortaket e shoqerise.

## OPERACIONET FINANCIARE


Neni 9

Shoqeria eshte e autorizuar per te siguruar mjete financiare dhe kredit duke ju drejtuar bankave, institucioneve te kreditit ose atyre te financimeve totale apo te jashtme, institucioneve nderkombetare te financimit dhe te kreditit sido qe te jete percaktuar.

## BLERJET E SHOQERIVE

Neni 10

Shoqeria disponon mjetet e saj ne perputhje me destinacionin e tyre dhe me objektin e shoqerise. Ne Republiken e Shqiperise, shoqeria gezon te drejten e saj per te zoteruar mjete te saj si ne cdo shoqeri tjeter ose organizate tregtare, kombetare shqiptare ne perputhje me Ligjin 9901 date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", i ndryshuar.



## FONDI REZERVE

### Neni 11

Shoqëria mund të themelojë një fond rezerve si dhe fonde të tjera të vecanta për zhvillimin e tij. Perberja, shumata totale, fondet për krijimin e tyre përdorimi dhe rregullimi i tyre (i çdo fondi) përcaktohet nga ortaku i vetëm në përputhje me legjislacionin shqiptar. Vlerat materiale të shoqërisë raportohen në bilancet të shprehur në leke shqiptare, në përputhje me rregullat në fuqi në Republikën e Shqipërisë. Bilanci dhe përlogaritjet ekonomike të shoqërisë hartohen mbi bazën e formës së bilancit dhe llogaritjeve ekonomike të përcaktuara për shoqëritë tregtare në Shqipëri. Bilanci vjetor mbyllet në 31 dhjetor të çdo viti.

## PLANET FINANCIARE

### Neni 12

Aktiviteti i shoqërisë mbi bazën e programeve financiare që bëjnë pjesë në aktivitetin financiar të saj. Planet financiare parashikojnë kostot dhe të ardhurat e shprehura në leke shqiptare. Gjendja pasurore dhe llogaritjet ekonomike do të paraqiten në leke shqiptare. Rezultatet financiare të aktivitetit dhe të punës së kryer nga shoqëria, paraqiten në bilancin vjetor. Kursi i këmbimit të monedhës shqiptare në monedhat e huaja dhe e kundërta do të jenë ato të vendosura nga Banka e Shtetit Shqiptar

## ORGANET E SHOQËRISË

### Neni 13

Organi vendimarrës i shoqërisë "**GRIMER GABION**" SHPK është asambleja e ortakeve e përbërë nga dy ortaket Z **Daniel Merko** dhe Z. **Dritan Gripshi**.

Asambleja e përgjithshme është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
- dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Asambleja e përgjithshme merr vendime për çështjet e përcaktuara në shkronjat "e" dhe "ë" të pikës 1 të këtij neni, pas marrjes dhe shqyrtimit të dokumenteve përkatës. Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;

c) investime;

ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmërinë, apo në bazë të rrethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.



## **MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

### **Neni 14**

Asambleja e përgjithshme mbledhet në rastet e përcaktuara nga ligji 9901, date 14.04.2008, nga ligje të tjera dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

Asambleja e përgjithshme thirret nga administratorët apo ortakët e përcaktuar sipas nenit 84 të këtij ligji.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar. Asambleja e përgjithshme thirret kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuar. Në rastet e parashikuara në pikat 3 deri në 5 të këtij neni, asambleja e përgjithshme mund të miratojë një rezolutë këshilluese, duke miratuar apo bërë vërejtje për veprimtarinë e administratorëve.

## **MËNYRA E THIRRJES**

### **Neni 15**

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## **KËRKESA NGA ORTAKËT E PAKICËS**

### **Neni 16**

Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 për qind të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, apo një pjesë më të vogël të parashikuar në statut, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim, përfshirë postën elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe/ose përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës. Kërkesa duhet të përmbajë arsyet, objektivat dhe çështjet, për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim. Nëse kërkesa refuzohet, këta ortakë kanë të drejtë ta thërrasin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës, në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose

çështja e kërkuar prej këtyre nuk futet në rendin e ditës, secili prej ortakëve, që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë:

a) të ngrejë padi në gjykatë, për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve;

b) t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave, të zotëruara prej tyre.

Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë përsëri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e nenit 14 të statutit. Përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethanë, të tillë që, sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesa të tjerë të ndryshëm nga ata të ortakut të përfaqësuar.

### **PËRFAQËSIMI NË ASAMBLE**

Neni 17

Ortakut mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë. Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

### **KUORUMI**

Neni 18

Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 për qind të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të Ligjit 9901, datë 14.04.2008, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

### **MARRJA E VENDIMEVE**

Neni 19

Me përjashtim të rasteve kur statuti parashikon një shumicë më të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj ose në statut, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit për shoqëritë tregtare, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës. Me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj, vlefshmëria e vendimeve, që përcaktojnë detyrime shtesë mbi ortakët, apo vendimet që kufizojnë të drejtat e tyre, të parashikuara në këtë ligj ose në statut, kushtëzohet nga miratimi i ortakut përkatës.

### **PROCESVERBALET E MBLEDHJES SË ASAMBLESË**

Neni 20

Të gjitha vendimet e asamblesë së përgjithshme duhet të regjistrohen në procesverbal. Administratorët përgjigjen për ruajtjen e kopjeve të procesverbaleve të mbledhjeve të asamblesë së përgjithshme.

Procesverbali duhet të përmbajë datën e vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të procesverbalit, rezultatet e votimit. Procesverbalit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si edhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme. Procesverbali i mbledhjes nënshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtësi i procesverbalit. Nëse shoqëria ka publikuar një faqe në internet, administratorët, jo më vonë se 15 ditë nga data



e mbledhjes, janë të detyruar të publikojnë kopje të procesverbalit të mbledhjes së asamblesë së përgjithshme në këtë faqe.

## **ADMINISTRATORI**

### Neni 21

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar administrohet nga nje ose disa persona fizike. Administratori i shoqerise emerohet me vendim te ortakeve te shoqerise. Afati i qendrimit ne detyre i administratorit te shoqerise eshte per nje periudhe 5 (pese) vjecare. Administrator i kesaj shoqerie eshte z. **Dritan Gripshi**.

Administratori i shoqerise i ka te gjitha kompetencat per te vepruar ne mardhenie me te tretet ne emer te shoqerise, ne te gjitha rrethanat, me perjashtim te kompetencave qe u njej ligji shprehimisht Asamblese se Ortakeve ose te treteve. Administratori ka pergjegjesi ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkeljete ligjeve, statutit apo shkeljeve te kryera gjate administratimit. Administratori ne rastin konkret kryen dhe harton raportet financiare, llogarite vjetore etj.

## **RASTET E PUNES**

### Neni 22

Raportet e punes ndermjet shoqerise, filialeve dhe agjensive te saj si dhe te punonjesve ne te, rregullohen ne baze te kontrates se punes, konform Kodit te Punes. Per sa nuk parashikohet ne kontraten e punes, aplikohen dispozitat e legjislacionit shqiptar ne fuqi.

### Neni 23

Shoqeria merr persiper, te shlyeje rregullisht te gjitha detyrimet e saj qe burojne nga legjislacioni per sigurimet shoqerore e shendetesore lidhur me te punesuarit e saj.

## **PERFUNDIMI I AKTIVITETIT**

### Neni 24

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar prishet:

- 1.Me kalimin e afatit per kohezgjatjen e saj ne kontraten e themelimit.
- 2.Per pamundesine e realizimit te objektit te saj.
- 3.Me vendimin e gjykates.
- 4.Me hapjen e procedurave te falimentit.

## **LIKUJDIMI**


### Neni 25

Likujdimi i shoqerise me pergjegjesi te kufizuar do te behet sipas normave te legjislacionit shqiptar ne fuqi ne kohen e likujdimit.

## **KUSHTET E TJERA**

### Neni 26

Te gjitha vendimet e mara nga asambleja e ortakut te veten evidentohen ne nje liber te vecante, i cili administrohet ne seline e shoqerise.



Per sa nuk eshte shprehur plotesisht dhe saktesisht ne kete, statut do ti referohen plotesimeve qe mund te beje ortaku I vetem si dhe ligjeve te vecanta te legjislacionit shqiptar ne fuqi.

Ky statut firmoset rregullisht

Per shoqerine tregtare **"GRIMER GABION" SHPK**

***Dy ortaket:***

**Dritan Gripshi**



A handwritten signature in cursive script, appearing to read 'Dritan Gripshi', written over a circular official stamp. The stamp contains the text 'KESHORITARI I KESHORITAREVE' and 'ELIASAN'.

**Daniel Merko**



A handwritten signature in cursive script, appearing to read 'Daniel Merko', written in black ink.

REPUBLIKA E SHQIPERISE  
DHOMA E NOTEREVE DURRES  
ZYRA NOTERIALE ELBASAN

NR.REP.900

Cel.0696272122

email.fkoseni@yahoo.com

Vertetim nenshkrimi

Sot me date 22/02/2017 (njetzet e dy shkurt dymije e shtatembedhjete), para meje noter Fatmir Koseni, Notere I Regjistruar prane Dhomes se notereve Durres, me studio noteriale ne Elbasan, u paraqiten:

**1. Daniel Merko**, atesia Sami ,lindur me 27.05.1974, lindur ne Elbasan, mbajtes i pashaportes nr.BF6398033, numer personal H40627169I, banues ne Elbasan, me zotesi te plote juridike e per te vepruar

**2. Dritan Gripshi**, atesia Tahsim lindur me 02.05.1975, lindur ne Peqin, mbajtes i pashaportes nr.BA6146956, numer personal H50502012O, banues ne lagja "Brigada 17 S", Elbasan, me zotesi te plote juridike e per te vepruar.


Te cilet me deklaruan se kane hartuar me deshiren dhe vullnetin e tyre te plote "STATUTIN" e shoqerise "**GRIMER GABION**" SHPK dhe e nenshkruajten ne pranine time.

Duke qene e sigurte per identitetin dhe vullnetin e tyre te lire dhe sipas ligjit per noterine nr.7829 date 01.06.1994, I ndryshuar vertetoj se nenshkrimi ne aktin bashkengjitur eshte i

**Dritan Gripshi dhe Daniel Merko.**

NOTER

Fatmir Y. Koseni

A circular notary seal for Fatmir Y. Koseni, Notere I Regjistruar, Durres. The seal contains the text 'REPUBLIKA E SHQIPERISE' at the top and 'ZYRA NOTERIALE ELBASAN' at the bottom. The signature 'Fatmir Y. Koseni' is written in black ink over the seal.